



**REPUBLIKA SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E FINANCEVE**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE**

**URDHER**

Nr. 01, date 09.11.2012

Mbi kompetencat ne leshimin e autorizimeve te perjashtimit nga Taksa Doganore, Akciza, TVSH dhe taksat e tjera

Ne zbatim te: neneve 199, 200, 203 te ligjit 8449 date 17.01.1999 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise" dhe neneve 477 deri 560 te VKM Nr. 205, date 13.04.1999 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", te ndryshuar; neneve 10, 59 dhe 80 te ligjit 6112012 "Per akcizat ne Republikën e Shqiperise" dhe neneve 17, 19, 20, 21 dhe 22 te VKM 612 date 05.09.2012 "Per dispozitat zbatuese te ligjit "Per akcizat"; ligjit 7928 dt 27.04.1995 "Per tatirnin mbi vleren e shtuar", i ndryshuar dhe udhezimit Nr. 17 dt 13.05.2008 "Per tatirnin mbi vleren e shtuar";

Ne kuader te ndryshirneve te reja te sjella me VKM Nr. 511, date 01.08.2012 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne VKM Nr. 205, date 13.04.1999 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", te ndryshuar; dhe

Me qellim administrimin, dhenien e nje autorizirni te vetern nga Drejtoria e Pergjithshrne e Doganave, ne rastet e perjashtirneve te ndryshme nga tarifa doganore, akciza, TVSH apo taksat e tjera, pa rene ndesh me delegimet per perjashtimet nga detyrimet ne deget doganore,

**URDHEROJ:**

1. Departamenti Teknik, Drejtoria e Tarifes dhe Origjines do te administroje perjashtimet sipas Nenit 199, 200, 203 te Kodit Doganor dhe konkretisht si vijon:

Perjashtimet nga detyrimet doganore ne baze te nenit 199 te Kodit Doganor:

1. Perjashtimet nga detyrimet doganore ne rastet e meposhtme :

- a. sende vetjake qe u perkasin personave fizike, qe ndryshojne vendqendrimin e tyre te zakonshem nga nje vend tjeter ne Republikën e Shqiperise;
- b..sende te importuara ne raste martese;
- c. sende vetjake te perfituara nga trashegimia;
- d. uniforma shkollore, pajisje e sende shkollore dhe sende te tjera me karakter jotregtar per perdorim nga nxenes e studente;
- e. dergesa me vlere te paperfillshme;
- f. mallra qe gjenden ne bagazhin vetjak te udhetareve;
- g. kafshe laboratorit dhe lende biologjike ose kimike qe nevojiten per kerkime;
- h. substanca terapeutike me origjine njerezore dhe reagente per percaktimin e grupeve, te gjakut e te perberjes se tij, organe njerezore per transplantime;

- i. lende referuese per kontrollin cilesor te produkteve mjekesore;
- j. prodhime farmaceutike te perdorura ne veprimtari sportive nderkombetare qe zhvillohen ne territorin doganor te Repulikes se Shqiperise;
- k. ndihma humanitare te ardhura ne adrese e per llogari te organizatave bamirese humanitare, te institucioneve te kultit, te enteve publike, si dhe te institucioneve shteterore buxhetore;
- l. dekorime dhe shperblime per tituj nderi;
- m. dhurata te perfituara ne kuadrin e marredhenieve nderkombetare;
- n. mallra per t'u perdorur nga kryetari i shtetit;
- o. mallrat e importuara me qellim nxitjeje te tregtise dhe reklamim veprimtarie;
- p. dergesa te destinuara per organizata qe mbrojne te drejtat e autorit, ose te drejta te tjera industrial apo tregtare;
- q. botime informative me karakter turistik;
- r. dokumentacione e artikuj te ndryshem, si detajohet ne aktet nenligjore ne zbatim te ketij Kodi;
- s. materiale te ndryshme per paketimin dhe ruajtjen e mallrave gjate transporimit te tyre;
- t. ushqime kafshesh dhe pajisje qe nevojiten gjate transportit te kafsheve;
- u. karburant dhe vajra lubrifikuese ne depoziten e automjeteve;
- v. arkivole, urna dhe zbukurime e pajisje funerarii per to, si dhe materiale qe sherbejne per ndertimin, mirembajtjen dhe zbukurimin e monumenteve ose varrezave te viktimave te luftes;
- w. furnizimet e bordit dhe pajisjet e nevojshme per funksionimin normal te mjeteve.

2. Perjashtimet me ligj te vecante.

3. Perjashtimet nga detyrimet e importit ne baze te marreveshjeve dypaleshe ose shume-paleshe te nenshkruara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise.

B. Perjashtimet per mallrat e rikthyera ne baze te nenit 200 te Kodit Doganor

C. Perjashtimet per produktet e peshkimit ne det dhe produkte te tjera te nxjerra nga deti ne baze te nenit 203 te Kodit Doganor.

**2. Departamenti i Akcizes, Drejtoria Teknike e Akcizes do te administroje perjashtimet si vijon:**

A. Perjashtimet nga akciza si dhe regjistrimet perkatese ne sistem, mbeshtetur ne Seksionin 2, nenit 10 te ligjit nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republikën e Shqiperise" si dhe te gjitha perjashtimet e tjera per secilen kategori produkti, te parashikuara ne Titullin II "Dispozita Specifike per produktet e akcizes" te Ligjit nr. 61/2012 "Per Akcizat ne Republikën e Shqiperise",

B. Perjashtimet nga TVSH, si dhe regjistrimet perkatese ne sistem, mbeshtetur ne nenin 20 deri ne 25 dhe ne nenet-25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8, 25.9 e 26.1 te Ligjit nr. 7928, date 27.4.-1-995, "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar", i ndryshuar te tilla si rastet e meposhtme por pa perjashtuar, gamen e plote te perjashtimeve sipas ketij ligji

- a. lendet e para dhe ambalazhet per prodhimin e barnave;
- b. barnat;
- c. arin dhe bankenotat;
- d. OJF qe kane autorizim nga Ministria e Financave;
- e. importimin e mjeteve, te cilat ndihmojne ne integrimin ne jete te invalideve paraplegjike dhe tetraplegjike, perfshire ketu dhe autovetura te pershtatura per perdorim prej tyre;

f.importimin e kafsheve te gjalla te races, te dhuruara nga donatore te ndryshem;  
g. furnizimin e pullave te postes per perdorim per sherbime postare ose pulla te ngjashme;  
h.importimin e anijeve, sipas nenkrereve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 te Nomenklatures se Kombinar te Mallrave; i.raste te tjera te parashikuara me ligj.

C. Perjashtime dhe regjistrime ne sistem per:

a. Operacionet hidrokarbure;

b. Perjashtimet per trupin diplomatik, forcat e NATO-s, per misionet diplomatike, konsullore, organizatat nderkombetare si dhe personelin e tyre.(vetem per karburantet)

c.Raste te tjera te nevojshme sipas kerkesave te ligjit.

3. Nese hasen raste qe nuk jane parashikuar shprehimisht ne kete urdher, departamentet komunikojne me qellim dhenien e nje autorizimi te vetem.

4.Ngarkohet Drejtoria e Tarifes dhe Origjines dhe Drejtoria Teknike e Akcizes te transpozojne, evidentojne dhe detajojne detyrat funksionale te strukturave te tyre ne Rregulloren e Brendshme Nr. 10168 Prot., date 7.06.2011 te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave.

5. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

**Flamur GJYMISHKA**

**DREJTOR I PERGJITHSHEM**